

DPK/DMP

03-4395/12

01

07.12.2012

Shifra :0499 RI.nr11523./12

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË FERIZAJ**, gjyqtarja Hysnije Gashi me sekretaren juridike Imrane Shabani, duke vendosur ne proceduren kundervajtese kunder te pandehurit, Avdullah Hoxha nga Ferizaj ,për shkak të kundërvajtjes nga neni 5.6 par.1.3 dhe neni 17 par 1.3 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Paurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin dhe prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar(Ligji nr.04/L050), në bazë të neneve 198 al.1 pika 10 të LK 31,73 , 195 të Ligjit mbi Kundërvajtjet me datë 29.11.2012 merr këtë:

### **A K T V E N D I M**

**PEZULLOHET** procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Avdullah Hoxha –Delegat ne Kuvendin Komunal ne Ferizaj,  
Nga një ekzemplar i këtij aktvendimi u dërgohet palëve.

### **A r s y e t i m i**

Agjencioni kunder Korrupcionit ne Prishtine,ka parashtruar kerkesen nr.01-2195/2012 te dates 15.06.2012 per fillimin e procedures kundrvajtese ndaj Avdullah Hoxhes ,Delegat I Kuvendit Komunal ne Ferizaj , pasi si zyrtar i lart publik nuk e ka plotsuar formularin per deklarimin dhe prejardhjen e pasurise ne afatin, e parapare ligjor.

Gjyqtarja filloi proceduren kundërvajtëse,,mori ne pyetje te pandehurin i cili ne mbrojtjene tij e kontestoi kundervajtjen e cila e vebet ne barre per faktin se Deklarimim e pasurise e kam bere me daten 29.03.2012te cilen ia prezenton Gjykates si prove por personi kontaktues Naser Musa emrin tim ne listen e Delegatesve te Kuvendit Komunal e ka shenuar Avdulla e jo Avdullah .Per vertetimn me te plote te gjendjes faktike gjyqtarja ftoi Parashtruesin e kerkeses Agron Behrami I cili ne tersi e vertetoi deklaraten e te pandehurit duke theksuar se ne formularin nga qendra e studenteve njefti figuron me emrin Avdulla ndersa ne listen e zyrtareve Komunal me emrin Avdullah.dhe nuk ka qene e kjarte a eshte nje person apody persona te ndryshem.dhe se I njeti deklarimine pasurise e ka bere me daten29.03.2012..

Në bazë të dhënave të përmendura më lartë u konstatua se janë plotësuar kushtet për PEZULLIMIN e procedures kundërvajtëse, në vështrim të neni 198 al.1 pika 10 LK, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendosur në Gjykatën komunale për kundërvajtje në Ferizaj, me daten 29.11.2012.

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankese Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj Gjykate, pa pagesë takse.

Sek.juridike  
Imrane Shabani

Gjyqtari,  
Hysnije Gashi